

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI BUDUĆI
FERIZAJ I UROŠEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

Më
Dana 28. 07. 2017
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I
PËRGJITSHËM DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtarin e
vetem gjyques Ilir Bytyqi si dhe me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani në lëndën penale
kundër të pandehurit [REDACTED] nga Ferizaj, per shkak te veprës penale 398 par. 2 lidhur me
par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II.nr.2550-1/2016 të datës 18.04.2017 në prezencën e
Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu si dhe të akuzuarit [REDACTED] pas mbajtjes së shqyrtimit
fillestare me datë 15.06.2017 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 20.06.2017 përpiloi
me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED]
e gjinisë [REDACTED] me vendbanim në Rr. [REDACTED] në [REDACTED] ka te kryer shkollën
e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së
Kosovës, me numër personal [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 14.10.2016, rreth orës 16:00, në rrugën “Reçakut” në Ferizaj, i pandehuri
ka ndryshuar dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si original,
ashtu që kishte shkuar në [REDACTED] për të bërrë pagesat e dy tiketave – gjoba të
trafikut, në emër të axhës së tij [REDACTED], por nuk kishte mundur të bëjë pagesën e tiketës
me numër serik 2045653, pasi stafi i bankës kishte dyshuar se i pandehuri kishte falsifikuar
ku datën 03.10.2016, e kishte ndryshuar - bërrë 08.10.2016, me qëllim që ti shmanget pagesës
50% më shtrenjtë, pas verifikimit nga policia ishte vërtetuar se data në tikete ishte falsifikuar.

*me të cilën ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 2
lidhur me par. 1 të KPRK-së.*

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 41, 46, dhe 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin Burim Aliu e

GJ Y K O N

DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200€ /dyqindë euro/, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguan në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë, sipas nenit 46 par. 3 të KPRK-së, i njëjtë dënim do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridikcionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2550-1/2016 te dt.18.04.2017, ka ngarkuar të akuzuarin [REDACTED] nga [REDACTED] për veprën penale veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrimit fillestare me datë 15.06.2017, në të cilën shqyrtim: *i pandehuri është dekluaruar fajtor për veprën për të*

cilën e ngarkon akuza, i vjen keq për këtë vepër penale, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i premton gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritet, lus gjykatën qe ti këtë parasysh këto rrethana, dhe të më shqipton një dënim sa më të but i cili do të arrinte qëllimi i dënitit.

Prokurori i Shtetit Valdet Avdiu, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerëuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësore, Gjykata për të vlerëuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga nenit 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit ne shqyrtimin fillestar dhe ne procedurën hetimore respektivisht ne deklaratën e datës 14.04.2017 si dhe tiketa e falsifikuar dhe kopja e tiketës me nr. serik 2042653 te cilat gjenden ne shkresat e lendes, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.
- me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj trupi gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerëuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënitit dhe për këtë arsyë ka vazhduar me shqiptimin e dënitit, (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënitit pa ploësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*).

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim fillestar publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: se me datë 14.10.2016, rreth orës 16:00, në rrugën “Reçakut” në Ferizaj, i pandehuri ka ndryshuar dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal, ashtu që kishte shkuar ne [REDACTED], për të bërë pagesat e dy tiketave – gjoba të trafikut, në emër të axhës së tij [REDACTED], por nuk kishte mundur të bëjë pagesën e tiketës me numër serik [REDACTED] pasi stafi i bankës kishte dyshuar se i pandehuri kishte falsifikuar ku datën 03.10.2016, e kishte ndryshuar - bërë 08.10.2016, me qëllim që ti shmanget pagesës 50% më shtrenjtë, pas verifikimit nga policia ishte vërtetuar se data në tikete ishte falsifikuar.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, për të pandehurin [REDACTED], të kryer në mënyrën dhe rr Ethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, edhe atë: veprimet e kundërligjshme të kryera nga i pandehuri kane cenuar marrëdhëniet juridike te vendosura me ligje për ruajtjen e paprekshmërisë se pronës dhe te drejtave pasurore të personave fizik dhe juridik, kjo vepër është kryer me ane të veprimeve aktive dhe të kundërligjshme duke ndryshuar dokumentin origjinal me qëllim të ndryshimit të atij dokumenti si origjinal, pasi që i pandehuri jo vetëm qe ka parashikuar pasojat e veprimeve të tij por edhe ka dëshiruar ardhjen e tyre, çka rezulton nga tërsia e rr Ethanave te kryerjes se veprës penale.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rr Ethanat të cilat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rr Ethanë veçanërisht lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë, ndërsa rr Ethanë lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real, nuk ka dëshmi se eshte gjykuar me vendim të formës së prerë, ndërsa në mungesë të rr Ethanave veçanërisht rënduese Gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi baze të këtyre rr Ethanave i shqiptoj dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimive i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënnimi i

shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së obligohet që në emër të shpenzimeve paushallit gjyqësore të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.984/2017, me datë 20.06.2017

Zyrtare Ligjore

Kadishe Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.